



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

Nr. 11473 prot.

Vlorë, më 14 07 .2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____. 2025

PËR MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT DHE TË VLERËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE SHTETËRORE TË PAPRIVATIZUARA

Këshilli i Bashkisë, në bazë të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore », neni 8/2, neni 9 pika 1.1/b,c, neni 30/2, neni 54 pika e,n, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social » të ndryshuar, neni 77/1,a, të VKM Nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara” dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike ;

V E N D O S I

1. Të miratojë privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara për qytetarët me të dhënat sipas tabelës së mëposhtme.
2. Të miratojë vlerën e apartamentit, që do të privatizojnë këta qytetarë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, neni 55, pika 6

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.banese	Struktura	Sipërfaqja/ m2	Vlera apartam. (lekë)	Vl.truallit lekë	Vl.plotë (lekë)
1	Fatos	Rexhep	Jaçe	1369	1+1	56,8	61338	111291	172629
2	Lilo	Barjam	Maska (trashëgimtar ët)	925	2+1	65,8	0	461262	461262
3	Galip	Sako	Isaj	1222	1+1	59,55	49655	106450	156105



KRYETAR

Ermal Dredha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

R E L A C I O N

Mbi projekt-vendimin "Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara"

Pranë Bashkisë Vlorë kanë paraqitur kërkesat për të privatizuar banesat shtetërore të paprivatizuara shtetasit si më poshtë:

1. Fatos Jaçe për apartamentin nr.9, me strukturë (1+1), i ndodhur në pallatin nr.1369, shkalla e parë, kati i katërt, me sipërfaqe 56,8 m², i poseduar në bazë të kontratës së qirasë me shtetin para vitit 1992. Viti i ndërtimit 1988. Sipas plan rlevimit të hartuar nga ing.top.i liçensuar sipas matjeve në vend ky apartament është pasuria me Nr.20/69+1-9, ZK 8604, me vendndodhje lagja "1 Maji", rruga "Mis Durham", Rajoni Nr.4, Vlorë.
2. Lilo Maska ka ndërruar jetë, në bazë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore kërkesa është paraqitur nga njëri prej trashëgimtarëve, Agron Maska, për apartamentin me strukturë (2+1), i ndodhur në banesën njëkatëshe nr.925, shkalla 1, kati 1, apartamenti nr.3, i poseduar në bazë të kontratës së qirasë me shtetin para vitit 1992. Është pasuria me Nr.7/110/3, ZK 8604, me sipërfaqe 65,8 m².
3. Galip Isaj për apartament me strukturë 1+1, me sipërfaqe 59,55 m², apartamenti nr.5, i ndodhur në pallatin 1222, lagja "Bashkimi", rruga "Enver Isaj". Është pasuria me Nr.7/6+1-5, ZK 8604.

Shtetasit sa më sipër kanë paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social» të ndryshuar, neni 77/1,a, në VKM Nr.179 datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara" dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore".

1. Vërtetim të lëshuar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike se këta persona kanë figuruar në numrat e banesave të përcaktuara, kanë paguar qiranë dhe nuk e kanë bërë privatizimin e banesës, për të cilën kanë pasur kontratë qiraje me shtetin para vitit 1992.

2. Çertifikatë familjare e 1.12.1992 dhe çertifikatë familjare aktuale.

3. Planimetri dhe plan rlevimi të banesës të hartuar nga ing. i liçensuar.

4. Në rastin kur personi që ka pasur kontratë qiraje me shtetin ka ndërruar jetë, është paraqitur dëshmia e trashëgimisë ligjore e nënshkruar para noterit.

Sipas akteve ligjore sa më sipër, vlera e privatizimit të banesës përbëhet nga ;

Vlera e privatizimit të truallit + vlera e privatizimit të apartamentit si ndërtesë.

Tarifa e privatizimit të truallit në përputhje me aktet ligjore sa më sipër është 1080 lekë/m².

Në rastin e banesave me dy ose më shumë kate vlera e truallit që i takon të paguajë familja përcaktohet nga koeficienti i bashkëpronësisë, sipas kuotës së pjesëmarrjes në bashkëpronësi.

Tarifa e privatizimit si ndërtesë përcaktohet në bazë të kategorisë dhe strukturës së apartamentit dhe korrigjohet në bazë të nivelit të banimit dhe vendndodhjes së apartamentit në godinë.

Vlera e privatizimit shumëzohet me indeksin e korrigjimit të çmimeve, duke marrë për bazë muajin dhjetor 1992.

Vlerat e privatizimit janë përcaktuar veçmas për secilën nga familjet dhe janë shënuar në tabelën pjesë e këtij projektvendimi.

Sa më lart, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë miratimin e projektvendimit për ti hapur rrugë regjistrimit në pronësi të këtyre apartamenteve për familjet që kanë paraqitur kërkesë pranë Bashkisë Vlorë.

Specialiste e Strehimit

D.Mustafai



Drejtor

Z.Selmani

